



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 qershor 2014
Nr. ref.:RK637/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI224/13

Parashtrues

Mustafë Osmani

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit për papranueshmëri
KI93/13, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 2 dhjetorit
2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Mustafë Osmani nga fshati Llaushë, komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin për papranueshmëri, KI93/13, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 2 dhjetorit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është e drejta e parashtruesit të kërkesës për të realizuar një pjesë të fitimeve nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore “Ramiz Sadiku” në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: NSH “Ramiz Sadiku”).
4. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pohon: *“Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në Prishtinë, lidhur me rastin tim të regjistruar në këtë Gjykatë Rasti nr. KI93/13 më datën 21.10.2013 ka vendosur që ta hedhë poshtë kërkesën time si të papranueshme, andaj, për këtë arsye këtë vendim e kundërshtoi si të kundërligjshëm”.*

Baza juridike

5. Kërkesa është shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 116.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme, Kushtetuta), dhe rregullat 63 (3) dhe 36 (3) f) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme, Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 10 dhjetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 13 janar 2014, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI224/13, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI224/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu (anëtarë).
8. Më 17 janar 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 14 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 12 mars 2009, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme ndaj listës përfundimtare të punëtorëve, të cilët kanë fituar të drejtën për të realizuar një pjesë të fitimeve nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku”, të përpiluar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.
11. Më 10 qershor 2011, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

12. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Kolegjin e Ankesave të Dhomës së Posaçme kundër vendimit të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme, të 10 qershorit 2011.
13. Më 22 prill 2013, Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme kishte vërtetuar vendimin e Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme dhe ankesën e parashtruesit e kishte refuzuar si të pabazuar.
14. Më 1 qershor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, që ishte regjistruar me numër KI93/13.
15. Më 21 tetor 2013, Kolegji shqyrtues, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, i kishte rekomanduar Gjykatës në përbërje të plotë që kërkesën KI93/13 ta hidhte poshtë si të papranueshme për shkak se ishte qartazi e pabazuar.
16. Më 2 dhjetor 2013, Gjykata nxori aktvendimin për papranueshmëri përkitazi me kërkesën KI93/13, dhe të njëjtin ia kumtoi parashtruesit të kërkesës dhe e publikoi në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.
17. Më 10 dhjetor 2013, parashtruesi dorëzoi një tjetër kërkesë duke kontestuar Aktvendimin për papranueshmëri, KI93/13, si të kundërligjshëm. Të njëjtin datë, kërkesa e parashtruesit u regjistrua në Gjykatë me nr. KI224/13.

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi pretendon se Aktvendimi për papranueshmëri, KI93/13, përmban shkelje procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
19. Parashtruesi pretendon se Aktvendimi për papranueshmëri, KI93/13, është i kundërligjshëm dhe se Gjykata duhet ta njohë të drejtën e tij për realizimin e një pjese të të ardhurave të krijuara nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku" në Prishtinë: *"sepse ai ka qenë viktimë e diskriminimit dhe se ka punuar disa vite në NSH 'Ramiz Sadiku' në Prishtinë"*.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje për të gjykuar kërkesën e parashtruesit, së pari është e nevojshme të shqyrtojë nëse janë plotësuar të gjitha kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
21. Përkitazi me kërkesën e parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, që përcakton:

"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës".
22. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 63 (3) të Rregullores së punës, që përcakton:

“Të gjithë personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar të respektojnë vendimet e Gjykatës dhe t’u përmbahen atyre”.

23. Gjykata, po ashtu, merr parasysh rregullin 36 (3) f) të Rregullores së punës, që përcakton:

“(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

...

f) kërkesa nuk është racione materiae në pajtim me Kushtetutën”.

24. Në rastin konkret, Gjykata thekson se vendimet e saj nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues, dhe si të tilla, janë të detyrueshme dhe përfundimtare për të gjithë personat fizikë dhe juridikë në Republikën e Kosovës.
25. Gjykata konsideron se kërkesat për rivlerësimin e vendimeve të nxjerra nga vetë Gjykata përbëjnë shkelje të së drejtës për peticion; mirëpo duke marrë parasysh se Gjykata ende është në fazën e saj të hershme të ndërtimit të praktikës gjyqësore, kërkesa e parashtruesit është regjistruar sërish në Gjykatë.
26. Në të vërtetë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka përcaktuar se *“çdo sjellje e parashtruesit e cila është qartazi në kundërshtim me qëllimin e të drejtës për peticion, siç parashihet në Konventë, dhe që pengon funksionimin e mirëfilltë të Gjykatës apo zhvillimin e mirëfilltë të procedurës, përbën abuzim të së drejtës në peticion”* (shih, *Mirolubovs dhe të tjerët kundër Lituanisë*, paragrafët 62 dhe 65).
27. Pavarësisht nga shtjellimi i gjertanishëm, Gjykata konsideron se ka dhënë vendim përfundimtar dhe të detyrueshëm përkitazi me kërkesën e parashtruesit për procedurën e zhvilluar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme; dhe se kërkesa nuk është *racione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
28. Rrjedhimisht, kërkesa është e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (3) f) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës dhe me rregullin 36 (3) f) të Rregullores së punës, më 14 mars 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani